

TECHNICAL DATA SHEET

MORTAR M-5

PËRSHKRIMI

Mortar M-5 është një llaç i parapergatitur me bazë çimentoje, i projektuar për ndërtimin e muraturave me tulla, blloqe betoni, gur ranore etj. Produkti është i gatshëm për përdorim kërkon vetëm shtimin e ujit në kantier, sipas përcaktimit në skedë teknike.

Në praktikë, kjo do të thotë se përdoruesi nuk ka nevojë të bëjë përzierje të veçanta me çimento, rërë dhe aditivë në objekt. Përzierja është e balancuar nga kompania për të siguruar punueshmëri, ngjitje dhe qëndrueshmëri të lartë. I klasifikuar sipas standartit EN 998-2 klasa M5. I gatshëm për përdorim për ambiente të jashtme dhe të brendshme. I lehtë në aplikim si me makineri dhe me dorë.



KARAKTERISTIKAT

1. Thjeshton dhe përshpejton aplikimin, sepse është produkt i gatshëm për përzierje vetëm me ujë.
2. Siguron rezistencë të lartë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare të muraturës.
3. Ka punueshmëri shumë të mirë, pra shtrihet dhe nivelohet lehtë me mistri gjatë ndërtimit të murit.
4. Është i përshtatshëm për përdorime të brendshme dhe të jashtme.
5. Falë granulometrisë së veçantë të grimcave, llaçi ka rrjedhshmëri të kontrolluar: shpërndalet mjaftueshëm lehtë, nuk bie dhe nuk shembet nga pesha e tullave, blloqeve ose elementeve të tjera të muraturës.

FUSHA E APLIKIMIT

Për ngritjen e mureve për ambiente të brendshme dhe të jashtme. Për blloqe çimentoje, guresh natyrore si dhe tulla të tipeve të ndryshme.

Përdorimi tipik është vendosja dhe lidhja e njësive të muraturës, ku llaçi shërben si shtresë lidhëse midis tullave ose blloqeve. Ai mund të përdoret në ambiente të brendshme dhe në fasada ose mure të ekspozuara jashtë, duke respektuar kushtet e aplikimit dhe kërkesat teknike të projektit.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Sigurohuni që tullat të jenë të pastra dhe pa pluhur. Përzierje me një përzierës mekanik ose me dorë 5-5.5 litra ujë me një thes 25 kg Mortar M-5 derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Produkti është i përshtatshëm për tu aplikuar me dorë dhe makineri.

APLIKIMI

Pasi të keni arritur drejtimin e duhur të tullave, aplikoni produktin me makineri ose me dorë deri në trashësinë 2 cm. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5°C deri në 35°C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje.

Rendi i rekomanduar praktik është: vendosja e sasisë së matur të ujit në enën e përzierjes, shtimi gradual i pluhurit, përzierja mekanike ose manuale deri në arritjen e masës së njëtrajtshme, dhe aplikimi i llaçit me mistri në sipërfaqen e muraturës.

Llaçi aplikohet me Mistri ose makineri. Gjatë aplikimit duhet të sigurohet që shtresa lidhëse të jetë e vazhdueshme dhe të mbulojë në mënyrë të mjaftueshme zonat e kontaktit midis elementeve të muraturës, në përputhje me praktikën e ndërtimit dhe specifikimet e projektit.

TECHNICAL DATA SHEET

MORTAR M-5

KUJTESE!

Mbani sa me shumë të jetë e mundur të pastër murin gjatë aplikimit. Në mot të nxehtë është e kes hillueshme që tullat dhe blloqet të lagen pak para vendosjes. Shmangni aplikimin në ditë me shumë erë mbi bazamente të ngrira apo edhe ne fazë shkrirje, me rrezik ngrirje në 24 orët e ardhshme dhe në temperatura nën 5°C.

MAGAZINIMI

Produkti ruhet për 12 muaj nga data e prodhimit, nëse mbahet në paketimin origjinal, të pahapur, në vende të mbrojtura nga lagështia dhe ngrica.

Në praktikë, thasët duhet të ruhen në paleta ose në sipërfaqe të thata, të mos jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dysheme të lagështa dhe të mbrohen nga shiu, kondensimi dhe temperatura shumë të ulëta.

Konsumi është Konsumi orientues është 20 kg/m² murature për tulla me dimensione 6 x 9 x 12 cm. Kjo vlerë është indikative. Konsumi real mund të ndryshojë në varësi të dimensioneve të tullave ose blloqeve, trashësisë së fugës, rrafshësisë së elementeve, mënyrës së aplikimit dhe humbjeve gjatë punës në kantier.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Gri
Kokrrizimi:	1.2 mm
Trashësia ne aplikim:	5-20 mm
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Ujë për përzierjen:	5 litra/thes
Temperaturat e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Masa vëllimore e thate:	1.7 g/cm ³
Konsistenca e llacit te fresket:	170mm
Rezistenca në ngjeshje:	5 N/mm ²
Konduktiviteti termik:	0.67 W/mK
Absorbimi i ujit	0.3 kg/m ² min0,5